

VENDIM
Nr. 69, datë 27.5.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE
PËR VITIN 2016, PËR KOMPANINË OST SHA**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, gjerat “a” dhe “e”; neni 60, pika 4 dhe 5; nenit 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 25, të “rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2016 për kompaninë OST sh.a., të përgatitur nga drejtoritë teknike,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin planit të investimeve për vitin 2016, për kompaninë OST sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti